

Prot. 8461

30 Dhjetor, 2016

Lënda: Kërkohet miratim për fillimin e negociatave midis Albpetrol sh.a. dhe Jurimex Kommerz Transit Ges.m.b.H mbi termat dhe kushtet kryesore të marrëveshjeve hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimet Gorisht-Kocul dhe Cakran-Mollaj.

Drejtuar: Z. Damian Gjikhuri, Ministër
Ministria e Energjisë dhe Industrisë

Për dijeni: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
Z. Viktor Tushaj, Drejtor Ekzekutiv

Jurimex Kommerz Transit Ges.m.b.H
Z. Robert Nowikovskiy

I nderuar Z. Ministër,

Shoqëria austriake Jurimex Kommerz Transit Ges.m.b.H. me eksperiencë të gjerë në industrinë e naftës dhe gazit, me letrën e tyre të datës 26 Shtator 2016 (referenca jonë: Nr. 6457 Prot., datë 28.09.2016), ka shprehur interesin për të hyrë në marrëveshje hidrokarbure me shoqërinë Albpetrol sh.a., për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimet Gorisht-Kocul dhe Cakran-Mollaj.

Në përgjigje të letrës së tyre, Albpetrol sh.a. ka informuar këtë shoqëri mbi statusin e këtyre vendburimeve (shih letrën tonë me Nr. 6457/1 Prot., datë 06.10.2016, me lëndë "Response to your letter dated September 26th, 2016"). Në vijim, shoqëria ka kërkuar të disponojë paketën me të dhënat teknike për këto vendburime, të cilat i janë vënë në dispozicion nga ana e Albpetrol sh.a. kundrejt pagesës.

Në bazë të vlerësimit paraprak që i ka bërë të dhënave teknike të sipërpërmendura, me letrën e tyre të datës 14 Nëntor 2016 (referenca jonë: Nr. 7516 Mod., datë 15.11.2016), shoqëria ka shprehur zyrtarisht interesin për të filluar negociatat mbi termat dhe kushtet kryesore në lidhje me marrëveshjet hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimet Gorisht-Kocul dhe Cakran-Mollaj.

Gjithashtu, me letrën e tyre përcjellëse të datës 19 Dhjetor 2016 (referenca jonë: Nr. 8256 Mod., datë 20.12.2016), shoqëria e interesuar ka dërguar edhe dokumentacionin provues në lidhje me kapacitetet teknike dhe financiare të cilat i gjeni bashkëlidhur.

... në dijeni, në lidhje me këto vendburime nafte, Albpetrol sh.a. ka lidhur dy marrëveshje hidrokarbure me shoqërinë Stream Oil & Gas Ltd. (sot TransAtlantic Albania Ltd.) të cilat mbyllen efektivisht më datë 18 Janar 2017, në bazë të njoftimeve të Albpetrol sh.a. me Nr. 6266 Prot. dhe Nr. 6265 Prot., të datës 19.09.2016.

Albpetrol sh.a. konfirmon gatishmërinë e saj për të bashkëpunuar me shoqërinë e interesuar, dhe për të vijuar me procedurat e mëtejshme, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, për negocimin e Termave dhe Kushteve Kryesore të Marrëveshjeve Hidrokarbure për vendburimet Gorisht-Kocul dhe Cakran-Mollaj.

Megjithatë, Ju bëjmë me dije se, pavarësisht kërkesës së shoqërisë së interesuar për të filluar me negociatat e Termave dhe Kushteve Kryesore, këto negociata mund të fillojnë vetëm në momentin që këto vendburime do të jenë të lira. Ky është një kushtëzim i parashikuar në Rregulloren "Për procedurat e miratimit të marrëveshjeve hidrokarbure dhe licencë marrëveshjeve si dhe afatet përkatëse", të ndryshuar me Urdhrin Nr. 121, datë 08.05.2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime [...]".

Për sa më sipër, referuar Nenit 5 të ligjit Nr. 7746, datë 28.07.1993 "Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi), të ndryshuar, Albpetrol sh.a. kërkon miratimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, për fillimin e negociatave mbi Termat dhe Kushtet Kryesore të Marrëveshjeve Hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimet Gorisht-Kocul dhe Cakran-Mollaj, duke përcaktuar njëkohësisht edhe momentin e fillimit të këtyre negociatave.

Në rast miratimi të kërkesës tuaj për fillimin e negociatave me këtë shoqëri, kërkojmë gjithashtu të na njoftoni emrat e përfaqësuesve nga MEI apo të ekspertëve të jashtëm që do të marrin pjesë në grupin negociator që do të ngrihet nga Albpetrol sh.a. për negocimin e Termave dhe Kushteve Kryesore të marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimet Gorisht-Kocul dhe Cakran-Mollaj në bazë të aplikimeve të paraqitura nga shoqëria e interesuar për secilin vendburim, të cilat i gjeni bashkëlidhur.

Mbetemi në pritje të përgjigjes Tuaj për sa më sipër.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

Me respekt,

Endri PUKA

Administrator i Albpetrol sh.a.

